



Bildungs- und Kulturdirektion
Direction de l'instruction publique et de la culture

Sulgeneckstrasse 70
3005 Bern
+41 31 633 85 11
gs.bkd@be.ch
www.bkd.be.ch

Bildungs- und Kulturdirektion, Sulgeneckstrasse 70, 3005 Bern

Drejtuar
prindërve dhe personave me të drejtë edukimi
të nxënësve dhe nxënësve të kantonit Bernë

2020.BKD.1588 / 306726

Bernë, 30 prill 2020

Shkollat hapin përsëri

Të dashur prindër dhe persona me të drejtë edukimi,
Të dashur nxënës dhe nxënës

Shkolla më dt. 11 maj 2020 i hap përsëri dyert e saj. Ne gëzohemi!

Javët e kaluara ishin për të gjithë ne një përvojë krejt e re dhe një sfidë e madhe. Të gjithë kanë bërë një punë shumë të mirë – mësueset dhe mësuesit, drejtoreshat dhe drejtorët e shkollave, punonjëset dhe punonjësit e ofertave të përkujdesjes – dhe natyrisht ju dhe familjet tuaja. Unë falënderoj të gjithë nga zemra për këtë.

Ne dëshirojmë që ta fillojmë riorganizimin e funksionimit të shkollës me kujdes. Në dy ditët e para mësimi bëhet në gjysmë klasa; drejtorja e shkollës do t'jua dërgojë informacionet e nevojshme. Personat mësimdhënës do të tematizojnë dhe ushtrijnë me nxënës dhe nxënësit masat për mbrojtjen e shëndetit. Me siguri këto masa do ta karakterizojnë jetën e përditshme në shkollë akoma për një kohë të gjatë. Nga dt. 13 maj 2020 mësimi do të fillojë pastaj, sipas mundësisë, përsëri me klasa të tëra.

Personat mësimdhënës i lutemi që të kujdesin gjatë fazës së parë në mënyrë të veçantë, tek cilët fëmijë në klasat e tyre janë krijuar boshllëqe/deficite. Të gjithë duhet të marrin kohë të mjaftueshme, për t'u orientuar përsëri në jetën e përditshme të shkollës. Jo të gjitha do të realizohen që në fillim. Por ne dimë që ne mund të llogarisim me drejtoritë e shkollave dhe personat mësimdhënës dhe gjithashtu me angazhimin tuaj dhe një bashkëpunim të mirë.

Është një dëshirë e madhe për mua që fëmijëve dhe të rinjve të mos u shkaktohet asnjë disavantazh për shkak të kësaj krize. Për raportet e vlerësimit para pushimeve verore kjo do të thotë se vlerësimet me rëndësi për notat do të bëhen me maturi dhe me sy. Parimisht vlejné arrijtet që janë realizuar para dt. 16 mars 2020 dhe nga dt. 11 maj 2020 do të kontrollohen vetëm kompetenca, të cilat mund të thelloheshin dhe ushtroheshin në mënyrë të mjaftueshme. Përveç kësaj, në vlerësimin e përgjithshëm duhet të hyjnë vetëm ato arritje, të cilat paraqesin një përmirësim për nxënësen ose nxënësin.

Gjatë vlerësimit personat mësimdhënës do t'u japin rëndësi të madhe zhvillimit të të mësuarit dhe përparimeve të mundshme të fëmijëve dhe të të rinjve duke marrë parasysh vitin e ardhshëm shkollor. Atëherë mund të shpërblehen angazhimi i madh dhe pavarësia e fëmijëve dhe të rinjve. Në rast

dysrimi vendimi për notat dhe vendimet për karrierën shkollore duhet të merren gjithmonë në favor të nxënësve dhe nxënësve.

A përfundon vajza juaj ose djali juaj shkollën në këtë verë? Nëse ai ose ajo nuk ka gjetur akoma një vend për mësimin profesional, unë me kënaqësi ju tërheq vëmendjen që afati për lidhjen e kontratave për mësimin profesional u zgjat deri në shtator të vitit 2020. Kështu që mos hiqni çdo shpresë! Vazhdoni të mbështetni vajzën tuaj ose djalin tuaj në kërkim për një vend të përshtatshëm për mësimin profesional. Edhe personat mësimdhënës, këshillimoret për zgjedhjen e profesionit dhe qendrat e informacionit (BIZ) dhe inspektoratet shkollore do t'ju mbështetin me kënaqësi gjatë kësaj.

Të dashur prindër dhe persona me të drejtë edukimi, të dashur nxënës dhe nxënës, unë ju falënderoj nga zemra për të gjitha, që ju keni bërë gjatë javëve të vështira të kaluara. Ne e kemi përballuar krizën deri tani së bashku, nxënëset dhe nxënësit, familjet, shkollat. Ne si shoqëri. Unë shpresoj dhe ju uroj juve dhe ne të gjithëve që tani së shpejti do të kthehet jeta e zakonshme e përditshme.

Unë ju uroj juve dhe familjes suaj gjithë të mirat dhe ju përshëndes përzemërsisht.

**Die Bildungs- und Kulturdirektorin
Drejtoresha për arsim dhe kulturë**



Christine Häsler
Regierungsrätin
Këshilltare qeveritare